



**KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT**  
**ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE**

Nr. Prot 379/1

Tiranë, më \_\_ Qershor 2022

Drejtuar:

Znj. Belinda Balluku  
Ministër  
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Z. Ergys Verdho  
Drejtor i Përgjithshëm  
Korporata Elektroenergjitike Shqiptare SHA

KESH sh.a HYRJE	
03 JUN 2022	
Nr. 2654	Prot.

Nga:

**Lënda:** *Kërkohet informacion mbi ecurinë e zbatimit të kontratës teknike për HEC Skavica.*

*E nderuar Znj. Ministre,*

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), në ushtrim të misionit të tij për mbrojtjen e të drejtave themelore të shtetasve, është njohur me ankesën e përcjellë nga qytetarja znj.

Ankuesja na informon se është përfaqësuese e një grupi informal të qytetarëve "Për Mbrojtjen e Pronave dhe Mjedisit të Pellgut të Drinit të Zi". Një ndër objektivat e këtij grupi është garantimi i të drejtës së konsultimit publik të qytetarëve mbi projektimin dhe ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës.

Sipas ankueses, edhe pse supozohet që projekti i HEC Skavica të jetë vetëm në një fazë fillestare, kompania e kontraktuar "Bechtel Limited" ka nisur aktualisht punimet për ndërtimin e projektit. Gjatë takimit të realizuar pranë zyrave të KShH-së, ankuesja referon edhe shqetësimin e banorëve të tjerë të zonës, të cilët nuk janë dakord me një projekt të tillë për shkak të impaktit që ai do të ketë, kryesisht në përmbajtjen e shtëpive dhe tokave që ata kanë në pronësi, shpronësimin e banorëve, si dhe efekteve që ky projekt do të ketë në florën dhe faunën e zonave përreth. Gjithashtu, ankuesja bën me dije se procesi i konsultimit publik të këtij projekti nuk është garantuar nga ana e autoriteteve kompetente, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik". Asnjë prej banorëve të zonës nuk ka marrë pjesë në një takim publik në të cilin të jenë sqaruar dhe informuar mbi paketën e projekt-akteve të hartuara për këtë çështje, si dhe t'ju jetë ofruar mundësia e adresimit të komenteve/rekomandimeve përkatëse për përditësimin e tyre.

Ankuesja pretendon se këto shqetësime i ka përcjellë në rrugë zyrtare edhe në adresë të institucionit që Ju drejtoni, e prej këtij të fundit i është vënë në dispozicion Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 458, datë 30.07.2021 "Për miratimin e Kontratës së Fazës së Parë "Kontratë Teknike - Projekti Hidroenergjitik i Skavicës" mes KESH Sh.A dhe Bechtel Limited.". Në përmbushje të misionit të tij Komiteti Shqiptar i Helsinkit mbështetur në nenin 11 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", kërkon të informohet si vijon:



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

---

1. Në cilën fazë të detyrave të parashikuara në Shtojcën 1 të VKM-së është aktualisht zbatimi i kontratës për shërbime teknike?
2. A është realizuar Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS) nga ana e ofruesit të shërbimit "Bechtel Limited", dhe nëse po a është konsultuar ky dokument me publikun? KShH kërkon të njohet me dokumentacionin e VNMS-së nëse disponohet në këtë fazë.
3. Në përputhje me parashikimet në Shtojcën 1 lidhur me raportet, evidentohet se subjekti "Bechtel Limited", dorëzon raport-progrese mujore mbi konstatimet, shërbimet e kryera sipas rastit duke identifikuar vërshtirësitë, vonesat, shkaqet dhe zgjidhjet potenciale për mbarëvajtjen e punimeve. A është respektuar nga ana e subjektit të kontraktuar ky detyrim kontraktual? KShH kërkon të njihet me kopjen e këtyre raporteve të progresit për të vlerësuar ecurinë e projektit dhe shqetësimet e ankueses.

Duke ju falenderuar paraprakisht për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të një përgjigje zyrtare nga ana Juaj.

**Me konsideratë,**